

LIGJ
Nr. 108/2016

PËR NJË NDRYSHIM DHE DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 8730, DATË 18.1.2001, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT TË PËRMBARIMIT GJYQËSOR”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8730, datë 18.1.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbaarimit Gjyqësor”, bëhen ndryshimi dhe shtesat si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 12, pika 2 shfuqizohet.

Neni 2

Pas nenit 12 shtohen nenet 12/a dhe 12/b me këtë përmbajtje:

“Neni 12/a

Tarifat fikse të veprimeve përmbaarimore

Për fillimin e procedurave të ekzekutimit dhe kryerjen e veprimeve procedurale nga Shërbimi Përmbaarimor Gjyqësor, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile, paguhet tarifa fikse. Masa e tarifës fikse caktohet duke mbajtur në konsideratë vlerën dhe llojin e detyrimit, si dhe kompleksitetin e veprimit procedural përmbaarimor.

Masa e tarifës fikse të veprimit përmbaarimor, llojet e veprimeve përmbaarimore të tarifuara dhe rastet e përjashtimit nga parapagimi i tarifës për kategori të caktuara përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave, pasi merret dhe mendimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbaarimit.

Neni 12/b

Tarifa e suksesit

Përmbaaruesi gjyqësor shtetëror përfiton një tarifë suksesi, e cila mund të jetë në formën e një shume të caktuar, një përqindjeje të caktuar mbi vlerën e detyrimit të vjelë ose titullit të ekzekutuar, ose nëpërmjet kombinimit të të dyjave mbi vlerën e detyrimit të ekzekutuar. Masa e tarifës së suksesit caktohet në marrëveshjen mes kreditorit dhe përmbaaruesit gjyqësor, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj.

Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave përcaktojnë me udhëzim të përbashkët nivelin minimal dhe maksimal të zbatimit të vlerës së tarifës së suksesit për veprimet përmbaarimore. Tarifa e suksesit nuk parapaguhet dhe nuk i ngarkohet debitorit.

Marrëveshja tip për mbledhjen e tarifës së suksesit nga Shërbimi Përmbaarimor Gjyqësor Shtetëror miratohet me urdhër nga Ministri i Drejtësisë.”.

Neni 3

Akte nënligjore

Ngarkohet Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave të nxjerrin aktet e përcaktuara në nenet 12/a dhe 12/b brenda 30-ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 4

Dispozitë kalimtare

Deri në miratimin e akteve të reja nënligjore do të zbatohen tarifat e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 27.10.2016

Shpallur me dekretin nr. 9870, datë 21.11.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani